



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:080354  
Datë: 18.03.2025  
Numri i dokumentit: 07006111

C.nr.754/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtar Vegim Maloku, në çështjen juridiko-kontestuese të paditësit L. K. nga Peja, rruga “H. e D.”, të cilin e përfaqëson Besim Ahmetaj avokat në Pejë, rruga “Mbretëresha Teutë” objekti – Semitroniks, kundër të paditurës K. e S. “S.” rruga “U. H.numë 1..., P., kati .. – Prishtinë, baza juridike, kompensim dëmi sipas auto – përgjegjësisë, vlera e kontestit 1000 euro, pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seance me datë 18.03.2025, bie këtë:

A K T V E N D I M

I.KONSTATOHET së është tërhequr padia e datës 12.03.2024, e parashtruar nga paditësi L. K. nga Peja, rruga “H. e D.”, kundër të paditurës K. e S. “S.” rruga “U. H. numë ..., P., kati ... – Prishtinë, nga baza juridike e kontestit: kompensim dëmi sipas auto-përgjegjësisë, vlera e kontestit: 1,000 euro.

*A r s y e t i m*

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij në këtë gjykatë me datë 12.03.2024, ka parashtruar padi kundër të paditurës, nga baza e kontestit: kompensim dëmi sipas auto-përgjegjësisë, vlera e kontestit: 1,000 euro.

I autorizuari i paditësit, me parashtruesën e datës 14.03.2025 të dorëzuar pranë kësaj gjykate, e ka bërë tërheqjen e padisë, me arsyetimin se paditësi me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtë gjyqësore.

Gjykata në kuptim të nenit 261 e lidhur me nenin 387, par 1, pika “c” të Ligjit për procedurën kontestimore vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2024:080354, C.nr.754/24, 18.03.2025

Udhëzim juridik: *Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa ne kuptim të dispozitës së nenit 261 par. 4 e LPK-së.*

G J Y Q T A R I  
Vegim Maloku